



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 13333 / Prot.

Fier më 26 .12.2024

VENDIM

Nr. 147 Dt. 23 .12 .2024

**“Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr.132 , datë 26/11/2024 “ Për një ndryshim në projektin “Ndërtim i KUZ-së, lagjja “Afrim“ Bashkia Fier, si dhe autorizimin e ekzekutivit të Bashkisë për vijimin e procedurave të shpronësimit për interes publik në kuadër të realizimit të këtij projekti”**

Këshillit të Bashkisë Fier, sot më Dt 23.12..2024, I paraqitet për shqyrtim materiali nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës dhe Drejtoria e Menaxhimit të Pronave , në lidhje me një ndryshim përsa I përket realizimit të projektit “Ndërtimi i KUZ-së së Lagjes Afrim ,Fier” Faza I,Zhvillues Bashkia Fier, në lidhje me pozicionimin e vaskës së trajtimit të ujërave, (gropës septike) , e cila me këtë ndryshim është pozicionur në pasurinë në përdorim të Bashkisë Fier , në pasurinë me nr.19/168, Zona Kadastrale Nr.8534, në sipërfaqe 927,6 m2, pasuri ne përdorim te Bashkisë Fier ,bazuar në VKM Nr.574 , datë 28/05/2009 “ Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme , publike shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Fier , Qarku Fier”.

Nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës është hartuar plani i vendosjes ku pasqyrohet ndryshimi I pozicionimit për realizimin e vaskës së trajtimit të ujërave, (gropës septike)

Procedurat administrative-ligjore të shpronësimit për interes publik në kuadër të realizimit të projektit “Ndërtimi i KUZ-së së Lagjes Afrim ,Fier” Faza I,Zhvillues Bashkia Fier, në lidhje me pasuritë të cilat preken nga gjurma e realizimit të tij do të rishikohen me ndryshimet e miratuara të gjurmës së tij.

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015,“Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 Pika 1.2, gërma “b”, Ligjin Nr.8561, datë.22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, VKM nr.89, datë 03/02/2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në nenin 54, gërma “k”, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI:**

I-Të miratojë ndryshimin e projektit të KUZ Afrim, lidhur me pozicionimin e gropës septike si pikë fundore e këtij projekti, sipas planvendosjes së paraqitur, e cila është pjesë e pandrë e këtij vendimi.

2- Të shfuqizojë vendimet e mëparshme të këshillit bashkiak, lidhur me ndryshimin e pozicionit të gropës septike, dhe të autorizojë Ekzekutivin për të vazhduar me procedurat e shpronësimit, për shkak se pasuria Nr. 19/168, Zona Kadastrale 8534, mbi të cilën ndërtohet gropa septike, është pronë shtetërore, sipas statusit juridik të konfirmuar nga ASHK-ja.

3- Ngarkohet Ekzekutivi i bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.

4- Ky vendim hyn në fuqi 19 ditë pas shpalljes.

**KRYETAR I KËSHILLIT**

**ANTONETA ÇUNAJ**

